

“JU JENI ARA E ZOTIT
dhe ne bashkëpunojmë me Hyjin”



VITI THIROR KOMBËTAR

tetor 2021
2022 qershor



lutja



promovimi



shoqërimi



JAVËT THIRRORE në DIOQEZAT

tetor 2-10
RRËSHEN

ntor 6-14
LEZHË

dhjetor 4-12
SHKODËR

shkurt
3 DITË FORMIMI

mars 5-13
SAPË

prill 2-10
TIRANË-DURRËS

maj 30 [prill]-8
(DBLTh)

JUGU

qershor

FESTIVAL

RINOR THIROR

RITET E HAPJES DHE MBYLLJES SË JAVËS THIRRORE

RITI I HAPJES SË JAVËS THIRRORE DIOQEZANE

(në Meshën e Mbrëmjes të së Shtunës së parë të muajit, dhe në Meshën e së Dieles së parë të muajit)

NË DIOQEZËN KU KREMTOHET JTHD-JA DHE NË DIOQEZAT E TJERA

PREZANTIMI PARA PROCESIONIT FILLESTAR

Të dashur vëllezër e motra,
në këtë vit baritor 2021-2022, me Hirin e Zotit krejt Kisha jonë në Shqipëri kremton VITIN THIRRROR KOMBËTAR: një Vit i kushtuar krejtësisht LUTJES dhe VEPRIMIT për THIRRJET në mbarë Kishën dhe sidomos në Kishën tonë në Shqipëri.

Ky Vit Thirrë do të kremtohet me Javët Thirrore nëpër Dioqeza në fillimin e çdo muaji, që me të vërtetë si një Familje e Vetme mund t'ia lartësojmë Zotit lutjen tonë “DËRGO, O ZOT, APOSTUJ TË SHENJTË NË KISHËN TËNDE”.

NË DIOQEZËN KU KREMTOHET JTHD –JA

(GJATË MESHËS SË MBRËMJES)

Sot, me kremtimin e kësaj meshe, hapim në Dioqezën tonë të JAVËN THIRRORE DIOQEZANE.

(GJATË MESHËS SË DITËS)

Dje, me kremtimin e Meshës së Mbrëmjes, kemi hapur në Dioqezën tonë të JAVËN THIRRORE DIOQEZANE.

Do të jetë një “javë e Hirit”, një javë në të cilën Zoti, për dashurinë dhe dhembshurinë e Vet ndaj Kishës sonë, do të na tregojë që “të korrat janë të mëdha, por punëtorë janë pak” dhe ne, me përgjegjësinë dhe me besimin tek Ai, do ta pranojmë urdhrin që Vet Jezusi na ka lënë “lutjuni, pra, Zotërisë së të korrave që të dërgojë punëtorë në të korrat e veta”.

(GJATË MESHËS MBRËMËSORE)

KRYQI THIRRROR do të sillet gjatë procesionit fillestar

(GJATË MESHËS SË DITËS)

KRYQI THIRRROR që kemi vendosur pranë altarit

na kujton që Hyji At’ ka shpëtuar secilin prej nesh nëpërmjet Vdekjes dhe Ringjalljes së Birit të Vet, dhe na ka mbledhur në një Kishë të Vetme duke na thirrur që të jemi misionarë për t’u lajmëruar Ungjillin të gjithë njerëzve.

Tani, me kremtimin e Eukaristisë së sotme, le të kërkojmë prej Atit, në Emër të Jezu Krishtit, ndihmën e Shpirtit të Shenjtë që ta jetojmë këtë Javë Thirrore Dioqezane me përkushtimin, që krejt bashkësia jonë dhe secili prej nesh të rritet në përkujdesjen ndaj çdo thirrjeje në shërbimin e Mbretërisë së Hyjit.

NË DIOQEZAT E TJERA

Sot me kremtimet e kësaj të Diele, në *Dioqezën e:

Tetor

RRËSHENIT

Nëntor

LEZHËS

Dhjetor

SHKODRËS

Mars

SAPËS

Prill

TIRANË-DURRËS

Maj

*ADMINISTRATURËS APOSTOLIKË TË JUGUT

hapet JAVA THIRRORE DIOQEZANE: do të jetë një “javë e Hirit” për të dëgjuar edhe një herë fjalët e Jezusit që na thotë “të korrat janë të mëdha, por punëtorë janë pak. Lutjuni, pra, Zotërisë së të korrave që të dërgojë punëtorë në të korrat e veta”.

Le të bashkohemi edhe ne, si dioqezë/famulli, me vëllezërit e motrat e Dioqezës së duke shoqëruar me lutjen tonë të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë kësaj Jave Thirrore.

Prandaj, tani, me kremtimin e Eukaristisë, le të kërkojmë prej Atit, në Emër të Jezu Krishtit, ndihmën e Shpirtit të Shenjtë që vëllezërit e motrat tona të kësaj Dioqeze të jetojnë këtë Javë Thirrore Dioqezane me përkushtim, në mënyrë që krejt Dioqeza dhe çdo besimtar të rritet në përkujdesjen ndaj çdo thirrjeje në shërbimin e Mbretërisë së Hyjit.

VJON PROCESIONI I HYRJES ME KËNGËN E HIMNIT TË VITIT THIROR

NË DIOQEZËN KU KREMTOHET JTHD-JA DHE NË DIOQEZAT E TJERA

LUTJA E BESIMTARËVE

Të dashur vëllezër e motra, duke falënderuar Hyjin për dhuratën e këtij Viti Thiror Kombëtar, me besim ia lartësojmë lutjet tona për të mirën e Kishës sonë në Shqipëri.

Të lutemi së bashku e të themi:

Dërgo, o Zot, apostuj të shenjtë në Kishën Tëndë!

Për Papën tonë Françeskun, për Ipeshkvin tonë, për të gjithë Ipeshkvinjtë dhe meshtarët: të thirrur nga Jezusi, Bariu i Mirë, si barinj të Kishës, të shikojnë vazhdimisht Atë për të udhëhequr me dashuri dhe përvujtëri popullin e besimtarëve. **Të lutemi:**

Për botën, e plagosur nga lufta, diskriminimi dhe dhuna: që ne, që quhemi të krishterë, të angazhohemi, secili sipas thirrjes së vet, ta përhapim kulturën e re që lind nga Ungjilli i cili na zbulon dinjitetin birëror të çdo njeriu, të krijuar nga Ati, i shpëtuar nga Biri dhe i banuar nga Shpirti i Shenjtë. **Të lutemi:**

Për të varfërit e të gjithë botës dhe sidomos për ata që jetojnë afër nesh: që ne si bashkësi të dimë të kujdesemi për ta, në mënyrë që askush prej tyre të mos ndihet i braktisur, përkundrazi që secili prej nesh të shenjtërohet përmes bamirësisë. **Të lutemi:**

[NË DIOQEZËN KU KREMTOHET JTHD-JA]

Për Dioqezën tonë të

[NË DIOQEZAT E TJERA]

Për Dioqezën e

që sot po fillon Javën Thirrore Dioqezane: që në këto ditë krejt Kisha e vendit, të rinjtë, familjet, vepruesit baritorë, të hapin zemrën ndaj Fjalës Sate që akoma sot thotë “Shkoni, ja po ju dërgoj”.

Të lutemi:

Për të gjithë ne, këtu të pranishëm: që sot e përgjithmonë të rritemi në dëgjimin e Zërit Tënd, që të jemi punëtorë të mirë për zhvillimin e Ungjillit në vendet e përditshmërisë ku jetojmë. **Të lutemi:**

O At’, ti je Zoti i të korrave, ne jemi arat e tua dhe Ti vetë ke kujdes për të gjithë ne duke dërguar në çdo kohë apostuj të Ungjillit të ndezur nga zelli për Mbretërinë Tëndë: dëgjo lutjet tona dhe bekoje angazhimin tonë për rritjen e thirrjeve në mes nesh. Nëpër Krishtin Zotin tonë.

HAPJA E ADHURIMIT EUKARISTIK NË VAZHDIMËSI

(Pas “Lutja pas Kungimit” vijon momenti i Adhurimit Eukaristik, që, sipas mundësive, mund të vazhdojë edhe pas Meshës)

KËNGË ADHURIMI

FTESA E LUTJES

MOMENT HESHTJEJE

LLAMBAT E THIRRJEVE

(pas çdo qëllimi lutjeje, nga fundi i kishës sillen qirinj që përfaqësojnë kategoritë e thirrjeve dhe vendosen pranë Kryqit Thirror, ndërkohë këndohen strofat e ndryshme të Himnit, si janë shënuar mëposhtë)

L1 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi: shiko me dashuri të rinjtë tanë: janë dhurata Jote për jetën e bashkësisë sonë. Dërgoje Shpirtin Tënd të Shenjtë në zemrat e tyre që të dëgjojnë Zërin Tënd që i thërret “Ejani pas meje”
(Sillet qiriri 1 - këndohet vargu 4)

L2 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi: shiko me bujari të varfërit e dioqezës sonë: janë gjymtyrët e Trupit Tënd që ti i ke zgjedhur si Prania Jote e dukshme. Dërgo Shpirtin Tënd të Dashurisë në zemrat tona që secili prej nesh të dijë të kujdeset konkretisht për të varfërit që ka afër.
(Sillet qiriri 2 - këndohet vargu 5)

L3 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi: shiko familjet e dioqezës sonë: janë “djepi” i të gjitha thirrjeve. Dërgo Shpirtin Tënd në zemrën e prindërve që të dinë të edukojnë fëmijet e tyre në dëgjimin e Zërit Tënd, që të gjejnë te Ty plotësimin e jetës së tyre.
(Sillet qiriri 3 - këndohet vargu 6)

L4 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi: shiko Dioqezën tonë dhe të gjithë popullin e Shqipërisë: jemi “arat e Tua” dhe duam të ecim në Rrugën Tënd: dërgo Shpirtin Tënd të Forcës në zemrat e të gjithë neve që, sipas shembullit të martirëve tanë, të angazhohemi për të qenë besimtarë të vërtetë, të bindur ndaj thirrjes që ia ke besuar secilit prej nesh.
(Sillet qiriri 4 - këndohet vargu 7 e 8)

MOMENT HESHTJEJE

LUTJA E VITIT THIRRROR KOMBËTAR

- * Nëse parashikohet që Adhurimi të vazhdojë së paku një orë pas Meshës, atëherë, kremtuesi dhe ministrat kthehen në sakristi, dhe Adhurimi vazhdon sipas orarit. Në momentin e rivendosjes së Sakramentit, Adhurimi përfundon si zakonisht: “Te Deum” dhe bekimi.
- * Nëse Adhurimi nuk do të vazhdojë pas Meshës, por do të rifillojë të nesërmen, atëherë kremtuesi përfundon si zakonisht: “Te Deum” dhe bekimi.

RITI I MBLYLLJES SË JAVËS THIRRORE DIOQEZANE

(në Meshën e Ditës të së Dieles së dytë të muajit)

PREZANTIMI PARA PROCESIONIT FILLESTAR

NË DIOQEZËN KU KREMTOHET JTHD-JA

Të dashur vëllëzer e motra,
me kremtimin e kësaj Meshe, mbyllim në Dioqezën tonë të JAVËN THIRRORE
DIOQEZANE.

Nga Ati kemi pranuar dhuratën e këtyre ditëve: bujaria me të cilën Ai mbolli farëra në
bashkësitë tona le të gjejnë tani angazhimin tonë për t'u përkujdesur për to.

Nga Jezu Krishti kemi dëgjuar edhe një herë shpalljen “Të korrat janë të mëdha, kurse
punëtorë ka pak. Lutjuni, pra, Zotërisë së të korrave, të dërgojë korrtarë në të korrat e veta”:
dhembshuria e Zemrës së Tij le të na gjejë gati për të thënë “ja ku jam, o Zot: ashtu si do
dërgomë mua”.

Nga Shpirti i Shenjtë kemi njohur që Mbretëria e Hyjit ndërtohet nëpërmjet shenjtërimit të
personave të thjeshtë, burra, gra, të rinj, fëmijë që thjesht jetojnë duke ndjekur Hyjin atje ku
janë dhe ashtu si janë: le të jemi edhe ne të guximshëm të jetojmë për Hyjin duke kërkuar të
jemi shenjtërit që i duhen Kishës dhe botës së sotme.

Kremtimi që po fillojmë, edhe pse mbyll Javën Thirrore Dioqezane, nuk do të jetë mbarimi i
punës sonë për thirrjet: përkundrazi, fillojmë këtë Meshë të Shenjtë me zemrën plot gëzim
dhe falënderim, gati për të vazhduar atë që kemi filluar në këtë Javë Thirrore Dioqezane.

NË DIOQEZAT E TJERA

Të dashur vëllëzër e motra,
sot me kremtimet e kësaj të Diele, në *Dioqezën e:

Tetor	RRËSHENIT
Nëntor	LEZHËS
Dhjetor	SHKODRËS
Mars	SAPËS
Prill	TIRANË-DURRËS
Maj	*ADMINISTRATURËS APOSTOLIKË TË JUGUT

mbyllet JAVA THIRRORE DIOQEZANE: të bashkuar shpirtërisht duam ta falënderojmë Zotin
për farërat që Ai ka mbjellë në jetën e besimtarëve të kësaj Dioqeze. E mira që Zoti ka bërë
në ta të jetë edhe në dobinë tonë e të mbarë Kishës në Shqipërinë.

Prandaj, me kremtimin e kësaj Eukaristisë sonë, le të kërkojmë prej Atit, në Emër të Jezu
Krishtit, ndihmën e Shpirtit të Shenjtë që vëllëzerit e motrat tona të kësaj Dioqeze të
kujdesen për ripërtërtjen e baritores thirrore, sipas fjalëve të Jezusit që thotë “Të korrat
janë të mëdha, por punëtorë janë pak. Lutjuni, pra, Zotërisë së të korrave që të dërgojë
punëtorë në të korrat e veta”.

VJON PROCESIONI I HYRJES ME KËNGËN E HIMNIT TË VITIT THIROR

LUTJA E BESIMTARËVE

Të dashur vëllezër e motra, duke falënderuar Hyjin për dhuratën e këtij Viti Thirror Kombëtar, dhe sidomos për javën Thirrore Dioqezane që u kremtua në Dioqezën (tonë) të , me besim ia lartësojmë lutjet tona për të mirën e Kishës sonë në Shqipërinë.

Të lutemi së bashku e të themi:

Dërgo, o Zot, apostuj të shenjtë në Kishën Tënde!

Për Papën tonë Françeskun, për Ipeshkvin tonë, për të gjithë Ipeshkvinjtë dhe meshtarët: të thirrur nga Jezusi, Bariu i Mirë, si barinj të Kishës, të shikojnë vazhdimisht Atë për të udhëhequr me dashuri dhe përvujtëri popullin e besimtarëve. ***Të lutemi:***

Për botën, e plagosur nga lufta, diskriminimi dhe dhuna: që ne, që quhemi të krishterë, të angazhohemi, secili sipas thirrjes së vet, ta përhapim kulturën e re që lind nga Ungjilli i cili na zbulon dinjitetin birëror të çdo njeriu, i krijuar nga Ati, i shpëtuar nga Biri dhe i banuar nga Shpirti i Shenjtë. ***Të lutemi:***

Për të varfërit e të gjithë botës dhe sidomos për ata që jetojnë afër nesh: që ne si bashkësi të dimë të kujdesemi për ta, në mënyrë që askush prej tyre të mos ndihet i braktisur, përkundrazi që secili prej nesh të shenjtërohet përmes bamirësisë. ***Të lutemi:***

[NË DIOQEZËN KU KREMTOHET JTHD-JA]

Për Dioqezën tonë të... ..

[NË DIOQEZAT E TJERA]

Për Dioqezën e

që ka kremtuar Javën Thirrore Dioqezane: që gëzimi i aktiviteteve që u zhvilluan në këto ditë të shtyjë krejt Kishën e vendit, të rinjtë, familjet, vepruesit baritorë për të gjetur mënyra të reja që ftesa e Jezusit “*eja dhe më ndiq*” të arrijë te të gjithë. ***Të lutemi:***

Për të gjithë ne, këtu të pranishëm: që sot e përgjithmonë të rritemi në dëgjimin e Zërit Tënd, që të jemi punëtorë të mirë për zhvillimin e Ungjillit në vendet e përditshmërisë ku jetojmë. ***Të lutemi:***

O At’, ti je Zoti i të korrave, ne jemi arat e tua dhe Ti vetë ke kujdes për të gjithë ne duke dërguar në çdo kohë apostuj të Ungjillit të ndezur nga zelli për Mbretërinë Tënde: dëgjoji lutjet tona dhe bekoje angazhimin tonë për rritjen e thirrjeve në mes nesh. Nëpër Krishtin Zotin tonë.

MBYLLJA E ADHURIMIT EUKARISTIK NË VAZHDIMËSI

(Pas “Lutja pas Kungimit” vijon Adhurimi Eukaristik si momenti i fundit i kremtimit)

KËNGË ADHURIMI

FTESA E LUTJES

MOMENT HESHTJEJE

LLAMBAT E THIRRJEVE DHE “DËRGIM THIRROR”

(U shpërndahen qirinj të vegjël të gjithë besimtarëve. Pas çdo qëllimi lutjeje, një person për kategori, ndez një qiri nga qiriri që është afër Kryqit Thirror dhe më këtë sjell dritën te të tjerët e asaj kategorie që janë në asamble [tek ata afër altarit, pastaj drita kalon te të tjerët]. Ndërkohë këndohen strofat e ndryshme të Himnit, si janë shënuar mëposhtë)

L1 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi:
shiko me dashuri të rinjtë tanë: janë dhurata Jote për jetën e bashkësisë sonë. Dërgoje Shpirtin
Tënd të Shenjtë në zemrën e tyre që të dëgjojnë Zërin Tënd që i thërret “Ejani pas meje”
(nga qiriri 1: një i ri te të rinjtë - këndohet vargu 4)

L2 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi:
shiko me bujari të varfërit e Dioqezës sonë: janë gjymtyrët e Trupit Tënd që ti i ke zgjedhur si
Prania Jote e dukshme. Dërgo Shpirtin Tënd të Dashurisë në zemrat tona që secili prej nesh të
dijë të kujdeset konkretisht për të varfërit që ka afër.
(nga qiriri 2: një nga Karitas te besimtarët e një pjesë të kishës - këndohet vargu 5)

L3 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi:
Shiko familjet e dioqezës sonë: janë “djepi” i të gjitha thirrjeve. Dërgo Shpirtin Tënd në zemrat
e prindërve që të dinë të edukojnë fëmijët e tyre në dëgjimin e Zërit Tënd, që të gjejnë te Ty
plotësimin e jetës së tyre.
(nga qiriri 3: një familje te familjet - këndohet vargu 6)

L4 O At', në Emër të Jezu Krishtit, i Pranishëm këtu në Sakramentin e Altarit, po të lutemi:
shiko Dioqezën tonë dhe të gjithë popullin e Shqipërisë: jemi “arat e Tua” dhe duam të ecim në
Rrugën Tëndë: dërgo Shpirtin Tënd të Forcës në zemrat e të gjithë neve që, sipas shembullit të
martirëve tanë, të angazhohemi për të qenë besimtarë të vërtetë, të bindur ndaj thirrjes që ia
ke besuar secilit prej nesh.
(nga qiriri 4: një ministrant tek ata që kanë mbetur - këndohet vargu 7 e 8)

MOMENT HESHTJEJE

LUTJA E VITIT THIRROR KOMBËTAR

Kremtuesi përfundon si zakonisht: “Te Deum” dhe bekimi.

HIMNI I VTHK-SË DHE KTHIMI NË SAKRISTI

